



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 696/5 Prot

Tiranë, më 10.11.2025

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr.49, datë 10.11.2025

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONIN E BASHKISË MALIQ
DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR RREGULLIMIN E
LIGJSHMËRISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e kryer në institucionin e Bashkisë Maliq,

VËREJ SE:

Me urdhërin nr. 66 (696 prot.), datë 7.7.2025, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Maliq”*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar mbikëqyrjen në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë nga ana e subjekteve të ngarkuara me detyra specifike për administrimin e procesit të rekrutimit dhe të disiplinës në shërbimin civil.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 696/1 prot., datë 7.7.2025, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Maliq me shkresën nr. 696/2 prot., datë

7.7.2025, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Maliq”*.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Mënyra e administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Maliq, si njësi e qeverisjes vendore, bazohet në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, ku është parashikuar në mënyrë të shprehur se: *“fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore”*.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i punës ka hartuar projektraportin për situatën e konstatuar, i cili i është dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 696/3 prot., datë 13.10.2025, të Komisionerit, duke i lënë 10 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes. Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, me shkresën nr. 5477/1 prot., datë 20.10.2025, *“Kthim përgjigje shkresës nr. 696/3, datë 13.10.2025”*, ka dërguar të nënshkruar projektraportin, pa vërejtje, duke sqaruar se do të përmirësojë situatën e administrimit të shërbimit civil.

Në raportin e mbikëqyrjes është konstatuar se gjatë miratimit të strukturës organizative të institucionit për vitin 2023 dhe 2024, struktura nuk është konsultuar me Komisionerin në kuadër të respektimit të skemës së administrimit të shërbimit civil, sipas orientimeve të dhëna në Udhëzuesit e Komisionerit:

- nr. 1082 prot., datë 14.12.2021, *“Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administrates vendore (bashki) për vitin 2022”*;
- nr. 654, datë 2.10.2024, *“Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në strukturën organizative të institucioneve të administratës vendore dhe transferimin e nëpunësve civilë për shkak të ristrukturimit të institucionit”*,

të cilët janë akte rregullative, që kanë dalë për të siguruar aplikimin e standardeve më të mira në ndërtimin e skemës së administrimit të shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet një vlerësimi real të pozicioneve të punës që e përbëjnë aktualisht skemën e administrimit të shërbimit civil, në referencë të nenit 19, të ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt, me qëllim që të përcaktohet me saktësi raporti i tyre me shërbimin civil, e për pasojë një strukturë ekonomike, efëiente dhe efektive.

E rëndësishme është të theksohet gadishmëria e institucionit, për të zbatuar detyrat e lëna nga Komisioneri në udhëzimet e përmendur më sipër, në drejtim të ngritjes së Komitetit të Vlerësimit të Pozicioneve të Shërbimit Civil, si dhe për njoftimin e subjekteve që janë pjesë e procesit të rishikimit të përshtimeve të punës (*aktet që materializojnë këto veprime janë administruar nga Komisioneri*), por nga ana tjetër, ende nuk janë arritur rezultate konkrete në lidhje me këtë proces. Për këtë arsye Komisioneri e vlerëson të rëndësishëm finalizimin e procesit të vlerësimit të pozicioneve të punës dhe më tej ndërtimin e strukturës sipas orientimeve konkrete që janë pasqyruar edhe në përmbajtjen e akteve rregulative të përmendura si më sipër.

Konstatohet se nga ana e institucionit, në përgjithësi, janë respektuar kërkesat e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet institutit të pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, ndërkohë që janë evidentuar edhe mangësi në drejtim të administrimit të shërbimit civil, të cilat janë vënë në dukje si konstatime në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ndër të cilat:

- ✓ Përsa i përket planit të pranimit në shërbimin civil konstatohet se, për vitin 2024 nuk është hartuar plani i rekrutimit, ndërsa për vitin 2025, nuk janë zhvilluar të gjitha procedurat e rekrutimit sipas planit të miratuar.
- ✓ Në **11** raste, konstatohet se janë emëruar punonjës në pozicione pune që i përkasin shërbimit civil, duke mos respektuar kërkesat e ligjit dhe procedurat që duhet të aplikohen për institutin e rekrutimit.
- ✓ Janë konstatuar mangësi në procedurën dhe përmbajtjen e proceseve administrative të kryera gjatë rekrutimit, të materializuara në aktet administrative që kanë dalë në përfundim të tyre, të tilla si:
 - në të gjitha konkurrimet e zhvilluara *mungon* çelësi i përgjigjeve të testimit me shkrim, të cilin anëtarët e Komitetit duhet ta kenë të administruar përpara zhvillimit të testimit me shkrim;
 - në të gjitha rastet mungon deklarata e paanësisë, të cilën duhet ta nënshkruajnë anëtarët e Komitetit, në fillim të procedurës së konkurrit, për të deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrim. Në këto kushte, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, duhet që në të gjitha procedurat e konkurrit që do të zhvillohen për plotësimin e pozicioneve të punës të shërbimit civil, të udhëzojë anëtarët e komisionit të vlerësimit që të nënshkruajnë deklaratën e paanësisë, për të deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrim. Deklarata duhet të bëhet pjesë e dosjes së konkurrit.

- ✓ Konstatohen mangësi në përmbushjen e detyrimeve që ka institucioni për nëpunësit civilë në periudhë prove:
- për 9 nëpunës, të cilët në datën 13.6.2025, janë emëruar “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, nuk është caktuar nëpunësi civil më i vjetër nën kujdesin e të cilit ata do të kryejnë detyrat gjatë periudhës së provës që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit.

Sjellim në vëmendje të institucionit dhe njësisë përgjegjëse se, procedura e konfirmimit apo jo të nëpunësit civil, duhet të jetë e plotësuar me të gjithë elementët, sipas parashikimeve të nenit 24, të ligjit, si dhe kreut VI, “*Periudha e provës*”, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar. Në lidhje me këtë aspekt, njësia përgjegjëse, duhet të kujdeset që eprori direkt i nëpunësit, të caktojë punonjësin që do të mbikëqyrë nëpunësin në periudhë prove dhe para se të nxjerrë vendimin e arsyetuar të konfirmimit, krahas vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës dhe certifikatës së trajnimit të detyrueshëm pranë ASPA-s, duhet të administrojë edhe mendimin e nëpunësit më të vjetër, nën kujdesin e të cilit është vendosur nëpunësi civil në periudhë prove. Më tej, zyrtarët e vlerësimit, krahas vlerësimit me notë në çdo rubrikë të formularit të vlerësimit, duhet të plotësojnë edhe ndarjen e dedikuar për komente dhe shpjegime. Vendimi për konfirmimin/moskonfirmimin e nëpunësit së bashku me aktet e tjera të hartuara në kuadër të procesit të konfirmimit, të përfshihen në dosjen personale të nëpunësit.

- ✓ Sa i takon administrimit të dosjeve të personelit, referuar parashikimeve të nenit 17 të ligjit, nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, konstatohet se:
- Në dosjet e personelit nuk është përfshirë “*Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit*” dhe “*Fletë inventari i dosjes së të punësuarit*”, që përmbajnë të dhënat e karakterit të përgjithshëm që lidhen me institucionin dhe të punësuarin si dhe listën e dokumenteve që vërtetojnë këto të dhëna. Në disa raste nuk është administruar akti i emërimit të punonjësit në pozicionin përkatës. Ky akt përfshihet në të dhënat parësore që lidhen me të punësuarin dhe përfshirja i këtij dokumenti në dosjen e personelit është i parashikuar në lidhjet 1 e 2 që i bashkëlidhen VKM nr. 833, dt. 28.10.2020 si pjesë e tij.

Komisioneri vlerëson se, mangësitë e konstatuara më sipër, duhet të rregullohen dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit, e cila e ushtron funksionin e saj në përputhje me të gjitha rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, gjatë veprimtarisë së saj, si dhe të gjithë nëpunësit e tjerë të angazhuar me detyra të administrimit të shërbimit civil, duhet të zbatojnë kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikat e evidentuara.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbytjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar; ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Bashkisë Maliq, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën sipas detyrave që do të evidentohen në vijim.
 2. Për përmirësimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, në lidhje me klasifikimin racional të pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë dhe klasën e zbatueshme për secilën kategori, në përputhje me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 152/2023, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe pikës 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, subjektet e ngarkuara prej ligjit, ndër të cilat Komiteti i Vlerësimit i ngritur me urdhrin nr. 1 (4247/1 prot.), datë 19.9.2024, të Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit, analisti i punës, njësia përgjegjëse dhe eprorët direkt për pozicionet e vlerësuara, duhet të finalizojnë procesin e nisur për vlerësimin e pozicioneve të shërbimit civil, duke ndjekur procedurën, sipas orientimeve të dhëna në udhëzuesit e Komisionerit.
- Vendimi përfundimtar i Komitetit të Vlerësimit dhe përshkrimet e rishikuara të punës, duhet të dërgohen pranë Komisionerit në përfundim të afatit të paralajmërimit.
3. Procesi i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës, duhet të pasqyrohet në aktin që shoqëron strukturën e paraqitur për miratim tek Kryetari i Bashkisë, nga njësia përgjegjëse, ose grupi i ngarkuar me këtë detyrë, (*relacion apo memo*) dhe të informohet Komisioneri për vendimmarrjen përfundimtare, duke i dërguar edhe aktin e miratimit të strukturës.
 4. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aktorët e tjerë të procesit, në bashkëpunim, duhet të evidentojnë nëpunësit që nuk kanë kryer detyrën për vlerësimin e pozicioneve të

shërbimit civil dhe hartimin e përshkrimeve të punës të rishikuara, të cilët do të përgjigjen personalisht për mosrealizimin e detyrave të ngarkuara. Më tej, të marrin masa të menjëhershme për finalizimin e procesit të vlerësimit të pozicioneve të punës dhe ndërtimin e strukturës sipas orientimeve të dhëna nga Komisioneri.

5. Pasi të përcaktohen në mënyrë përfundimtare pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, klasat e zbatueshme për secilën kategori, si dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë, të rishikohet plani i rekrutimeve në shërbimin civil, duke përfshirë në këtë akt, të gjitha vendet vakante që kanë dalë nga procesi i vlerësimit. Në planin e rekrutimit, në përputhje me strukturën finale të institucionit, të përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira, si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin, me emërim të përkohshëm, duke pasqyruar një planifikim të qartë të rekrutimit, ku të evidentohet përkatësisht, pozicioni i punës dhe afati konkret se kur do të realizohet konkurrimi për plotësimin e tij.
6. Pasi të kryhen të gjitha detyrat që janë lënë në pikat 2; 3; 4 dhe 5 të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë Maliq, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për punonjësit e emëruar në kundërshtim me ligjin, në pozicione pune që rregullohen nga ligji për nëpunësin civil dhe të rregullojë pasojat, duke i shpallur pozicionet e lira pranë AKPA-së, për tu plotësuar në përputhje me ligjin. Në momentin e shpalljes së pozicionit të lirë të punës, për tu plotësuar nëpërmjet konkurrimit, pozicioni duhet të jetë efektivisht i lirë, për të respektuar në këtë mënyrë parimet e pranimin në shërbimin civil, ndër të cilat parimin e shanseve të barabarta dhe profesionalizmit. Ky veprim do të rivendosë situatën e ligjshmërisë dhe do të mundësojë procesin e rekrutimit sipas kërkesave specifike që rregullojnë këtë institut të ligjit.

Bëhet fjalë për pozicionet e punës, të cilat aktualisht janë të zëna nga punonjës të emëruar përkohësisht, sipas akteve që do të evidentohen në vijim, të nxjerra në kundërshtim me ligjin:

✓ **Pozicione pune në nivelin e kategorisë së ulët apo të mesme drejtuese:**

- Irsida Polena, me akt emërimi nr. 1578 prot., datë 27.3.2017, të Njesisë përgjegjëse, është emëruar “Nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin “Specialist i Projekteve”. Me urdhrin nr. 325, datë 24.6.2024, të Kryetarit të Bashkisë është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Integritimit European dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj”, pa u zbatuar procedurat ligjore të ngritjes në detyrë.
- Roneldi Spaho, me akt emërimi nr. 195 (1875 prot.), datë 16.11.2015, të Njesisë përgjegjëse, është emëruar “Nëpunës civil në periudhë prove”, në pozicionin “Nëpunës i Mbrojtjes Civile në Njësine Administrative Vreshtas”. Me urdhrin nr. 511 (5366 prot.),

datë 5.10.2023, të Kryetarit të Bashkisë “Për ndryshimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin 2023”, lidhja nr. 1 “Administrata e Bashkisë Maliq viti 2023”, numër rendor 60, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Territorit, Administrimit të Lejeve dhe Legalizimeve”, pa u zbatuar procedurat ligjore të ngritjes në detyrë.

- Ermanda Petriti, me akt emërimi nr. 2285, datë 22.05.2019, të Njesisë përgjegjëse, është emëruar nëpunës civil, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Ndihmës Ekonomike”. Me urdhrin nr. 476/1 (4438/1 prot.), datë 3.10.2024, të Kryetarit të Bashkisë, “Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelin e pagave të Administratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera të varësisë”, lidhja nr. 1, “Administrata e Bashkisë Maliq shtator 2024 e në vazhdim”, nr. rendor 98, është emëruar në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Shëndetësisë”, pa u zbatuar procedurat ligjore të ngritjes në detyrë.
- Luan Riska, emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës, Këshillimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”, me urdhrin nr. 124 (2252 prot.), datë 6.4.2023, të kryetarit.
- Florenc Muçollari, emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shëndetësisë dhe Arsimit”, me urdhrin nr. 683 (6367 prot.), dt. 31.12.2024, të Kryetarit “Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të varësisë”, lidhja nr. 1, “Administrata e Bashkisë Maliq viti 2025”, nr. rendor 145.
- Joana Hoxha, emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Sociale”, me urdhrin nr. 215 (2346/1 prot.), datë 22.4.2025, të kryetarit.

✓ **Pozicione në kategorinë ekzekutive:**

- Ledjo Plaka, emëruar në pozicionin “Specialist në Sektorin e Pronave Publike dhe Aseteve”, me urdhrin nr. 230 (2725 prot.), datë 12.5.2023, të kryetarit.
- Elsa Çoçka, emëruar në pozicionin “Specialist Personeli në Sektorin Juridik dhe Burimeve Njerëzore”, me urdhrin nr. 150 (1555 prot.), datë 18.3.2024, të kryetarit.
- Stivi Fejzollari, emëruar në pozicionin “Specialist/Programues Baze të dhënash, në Sektorin e Planifikimit të Territorit/Administrimit të Lejeve/Legalizimeve”, me urdhrin nr. 683 (6367 prot.), datë 31.12.2024, të Kryetarit “Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera të varësisë”, lidhja nr. 1, “Administrata e Bashkisë Maliq viti 2025”, nr. rendor 94.
- Kejdi Hasani, emëruar në pozicionin “Specialist Agroushqimi në Sektorin e Shëndetësisë dhe Arsimit”, me urdhrin nr. 683 (6367 prot.), dt. 31.12.2024, të Kryetarit “Për miratimin

e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera të varësisë”, lidhja nr. 1, “Administrata e Bashkisë Maliq viti 2025”, nr. rendor 146.

- Xhulia Vojkollari, emëruar në pozicionin “Specialist për Arsmimin dhe Kulturën në Sektorin e Shëndetësisë dhe Arsimit”, me urdhrin nr. 683 (6367 prot.), dt. 31.12.2024, të Kryetarit “Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera të varësisë”, lidhja nr. 1, “Administrata e Bashkisë Maliq viti 2025”, nr. rendor 149.

Në mbështetje të dispozitave ligjore të parashikuara në nenet 108, 110 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, emërimet nga Kryetari i Bashkisë Maliq, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, për punonjësit Irsida Polena, Roneldi Spaho dhe Ermanda Petriri, duhet të konstatohen si absolutisht të pavlefshëm nga vetë organi që e ka bërë emërimin, në këtë rast Kryetari i Bashkisë. Pas këtij veprimi njësia përgjegjëse duhet të rikthejë punonjësit si më sipër në pozicionet e mëparshme të punës, ku ata janë konfirmuar si nëpunës civilë ose në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori ku ata plotësojnë kriteret e posaçme nëse pozicioni i mëparshëm është plotësuar nëpërmjet procedurave të konkurrimit.

7. Eprori direkt, për punonjësit që aktualisht janë në periudhë prove, të caktojë punonjësit që do të mbikëqyrin nëpunësit në periudhë prove dhe në përfundim të saj, zyrtarët e vlerësimit të kryejnë vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën e provës, duke vlerësuar me notë çdo rubrikë të formularit të vlerësimit, si dhe të plotësohet ndarja e dedikuar për komente dhe shpjegime.

Eprori direkt, bazuar në rezultatet e testimit në përfundim të trajnimit të detyrueshëm në ASPA, vlerësimin e rezultateve individuale në punë, si dhe mendimin me shkrim të nëpunësit më të vjetër, nën kujdesin e të cilit është vendosur nëpunësi në periudhë prove, të nxjerrë vendimin e arsyetuar të konfirmimit/zgjatjen një herë të vetme deri në 6 muaj të periudhës së provës/moskonfirmimin, sipas rastit dhe të njoftojë nëpunësin dhe njësinë përgjegjëse.

8. Dosjet e personelit të nëpunësve civilë të plotësohen dhe sistemohen nga njësia përgjegjëse, në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe kërkesave të vendimit nr. 833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit”.

Në dosjen e personelit të administrohen të gjitha aktet e emërimit, që pasqyrojnë në mënyrë kronologjike lëvizjet e punonjësit nga momenti i fillimit të marrëdhënieve juridike të punës dhe atyre financiare e në vijim, (aktet që pasqyrojnë ndryshim të pozicionit të punës,

strukturim të pozicionit të punës, ndryshim të kategorisë së pozicionit të punës etj, ndryshime që lidhen me pozicionin e punës).

9. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 (katër) muaj** nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në raportin përfundimtar.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke dërguar edhe aktet që vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna.

10. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Maliq, Prefekti i Qarkut Korçë, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjensia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Maliq, duhet të njoftojë për këtë vendim, çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin si dhe çdo subjekt tjetër i cili është ngarkuar me detyra të posaçme, në raportin përfundimtar dhe në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

11. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, nga subjektet përkatëse, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha